



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.09.2023

**MBLEDHJA Nr. 49,**  
**Datë 25.09.2023, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 25.09.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 49 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.09.2023.
2. Mbi miratimin e “Kontratës TIP për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.
3. Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike
4. Mbi miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” shpk, për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguroese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve
6. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “TEKSOEN 1”
7. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.21, datë 25.01.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “PISHAT”, me kapacitet të instaluar 1911 kW”
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “GERTI” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “VARDARI” me kapacitet të instaluar 1972 kW”, i ndryshuar

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARI I BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**